

Përshëndetje,

Duke uruar të Jeni mirë, në vijim të kërkesës Tuaj me nr.199/25 Prot., me lëndë: "*Kërkesë për informacion dhe vënie në dispozicion e dokumentacionit*", **ndodhur në cilësinë e Koordinatorit për të Drejtën e Informimit të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, Ju informoj sa më poshtë vijon:**

- ***Në lidhje me numrin e subjekteve të cilët i janë nënshtruar kontrollit për periudhën 01.01.2025 - 20.12.2025***, Ju bëjmë me dije se nga Drejtoritë Rajonale të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, përgjatë kësaj periudhe janë kryer gjithsej **21,772** (*njëzet e një mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e dy*) inspektime në total;
- ***Në lidhje me masat administrative 'gjobë', të cilat janë vendosur gjatë kësaj periudhe***, Ju bëjmë me dije janë vendosur gjithsej **428** (*katërqind e njëzet e tetë*) masa administrative 'gjobë';
- Së fundmi, për sa i përket kërimit për një ***kopje të listës së subjekteve ndaj të cilëve është vendosur gjoba***, në përputhje me formën e kërkuar të informacionit nga ana Juaj (*adresë e-mail-i*) po Ju përcjellim bashkëlidhur, listën e subjekteve (me iniciale) ndaj të cilëve është vendosur gjobë.

Faleminderit,